



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality
Zyra e Kryetarit/Kancelarija Predsednika/President office



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Në bazë të nenit 12 pika d), të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/15, 28 qershor), nenit 56 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr. 06 -103/1 të datës 11.09.2008, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën, 29.06.2023 pas shqyrtimit dhe votimit paraprak, miraton këtë:

VENDIM

Neni I

THEMELOHET komisioni për verifikimin e mungesave në paga të delegatëve të Kuvendit të Komunës së Dragashit:

1. Nexhat Selaj – PDK,
2. Samidin Xheladini – LDK,
3. Munir Jonuzi – VAKAT,
4. Uran Halimi – LVV,
5. Edin Kurt – JGP,
6. Agron Gashi – AAK,
7. Nedzmidin Sejdić – PG.

Neni II

Detyrë e komisionit është, që nga fillimi i mandatit të Delegatëve të kësaj legjislatore (2021-2024), që të i shiqoj veç e veç secilin delegat që ka mungesa në pagë, të i llogarisë se sa paga nuk i janë paguar dhe të del me raport përfundimtar, dhe të Obligohet zyra e personelit që të i kompensoj të gjitha këto mjete.

Neni III

1. **OBLIGOHE**t zyra e Kuvendit që të i ofrojë komisionit të gjitha listat e pjesëmarrjes së Delegatëve në seanca dhe komitete.
2. **OBLIGOHE**t zyra e personelit që të i lejoj qasje komisionit në listat e pagave dhe listat që janë dërguar në Ministri të Financave për delegatët të cilët kanë mungesa në paga dhe në momentin e vertetimit të mungesave të pagave për muajt e caktuar të i kompensoj brenda afatit ligjor.
3. **OBLIGOHE**n Delegatet e Kuvendit që të e nxjerrin qarkullimin bankar për verifikimin e pagave dhe të bëhet krahasimi me listat e pagave dhe listës që dërgohet në MF.

Neni IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në protokollin e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës së Dragashit.

I dërgohet:

- MAPL-së (zyra ligjore) – Prishtinë;
- Anëtarëve të komisionit;
- Kryetarit Komunës – z. Bexhet Xheladini;
- Arkivit;

KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

01Nr. 060/01-13361-2/23

Dt. 29.06.2023



Kryesuesi i Kuvendit
Uran Halimi